



KAPITULLI

24

DREJTËSI, LIRI, SIGURI



Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin European 2023–2024

Ky punim u përgatit nga Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në kuadër të projektit “Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri”, me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian nëpërmjet Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA).

nëntor 2024, Tiranë



Dëftesa E Progresit Dhe Nivelit Të Përgatitjes Së Shqipërisë Drejt Anëtarësimit Në Bashkimin Europian 2023–2024

SIPAS VLERËSIMEVE TË RAPORTEVE TË KOMISIONIT EUROPIAN 2023 DHE 2024

KONTEKSTI

Komisioni Europian (KE) monitoron progresin dhe nivelin e përgatitjes së Shqipërisë në përmbushjen e kërkesave të anëtarësimit mbi një bazë vjetore. Vendi po punon për transpozimin e Acquis sipas Planit Kombëtar të Integritimit Europian (PKIE) i cili shërben si mjet për plotësimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA). Mbajtja e Konferencës së Parë Ndërqeveritare, më 19 korrik 2022 ishte një ngjarje historike për vendin tonë pasi mishëron aspektin teknik të procesit të integritimit në BE. Konferenca hapi rrugën për miratimin e kuadrit negociator të hartuar nga Komisioni Europian dhe fillimin e procesit screening. Me përfundimin me sukses të procesit screening në nëntor 2023, një tjetër hap me rëndësi u hodh në kuadër të procesit të integritimit, ai i hapjes së negociatave për Grupkapitullin 1 - Themeloret në tetor 2024.

Kjo Dëftesë mbi Progresin dhe Nivelin e Përgatitjes së Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE merr si pikënisje gjendjen e përshkruar në Raportin e KE 2023 dhe pasqyron zhvillimin gjatë një viti, kristalizuar në Raportin e KE 2024. Ajo synon të shfaqë në një gjuhë më të lexueshme 1) Kriterin politik; 2) Kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) dhe 3) Kapitullin 24 (Drejtësia, Liria, Siguria).

Dëftesa paraqet një vlerësim për çdo nënçështje të secilit kapitull. Vlerësimi përfshin një shtjellim të progresit dhe përgatitjes gjatë periudhës së raportuar në raportin e KE 2023 dhe 2024 në secilën fushë, si dhe një vlerësim me notë (ku 10 është nota më e lartë dhe 4 më e ulëta), ku merr parasysh terminologjinë e përdorur në çdo rast në Raportet e Komisionit Europian për progresin dhe nivelin e përgatitjes.

Për më tepër, merr në konsideratë shpeshësinë me të cilën ajo është përdorur, kombinuar me rëndësinë e çështjes (për shembull, nismat e reja ligjore apo strategjitë përgjithësisht janë vlerësuar më të rëndësishme se trajnimet rutinë apo përmirësimet modeste në kapacitete). Fokus i veçantë i është dhënë vlerësimit të zbatimit të legjislacionit si një nga problemet më të rëndësishme që has vendi ynë. Metodologjia e aplikuar nga EMA përbën një fotografim të disa përbërësve që formësojnë një nënfushë, fushë e më pas kapitullin.

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR PROGRESIN	NOTA
Hapa mbrapa (Backsliding)	4
Mungon progresi (No progress)	5
Progres i kufizuar (Limited Progress)	6
Njëfarë progresi (Some progress)	7
Progres i mirë (Good Progress)	8–9
Progres shumë i mirë (Very good progress)	10

TERMINOLOGJIA E PËRDORUR PËR PËRGATITJEN	NOTA
n/a	n/a
Fazë e hershme (Early stage)	5
Njëfarë niveli përgatitje (Some level of preparation)	6
Njëfarë niveli/ Përgatitje mesatare (Some level / moderately prepared)	7
Përgatitje mesatare (Moderately prepared)	8
Nivel i mirë përgatitjeje (Good level of preparation)	9
Nivel i përparuar përgatitjeje (Well-advanced)	10

Si Duhet Lexuar Dëftesa?

Dëftesa e Shqipërisë paraqet notat për çdo fushë, në bazë të analizës nga Komisioni Europian për progresin dhe përgatitjen e bërë apo të munguar në procesin e integritimit evropian. Vlerësimi i fushave është realizuar duke marrë parasysh disa kritere si:

- Vlerësimi i përmbushjes së kërkesave dhe detyrimeve që burojnë nga procesi në kuadër të hartimit të legjislacionit.
- Vlerësimi i ecurisë së procesit duke u nisur nga gjetjet e raportit të vjetshëm me zhvillimet deri në publikimin e raportit të ri.
- Marrja parasysh ose jo e rekomandimeve të një viti më parë.

Nëpërmjet kësaj Dëftese, synohet t'u ofrohet aktorëve të shoqërisë civile, akademikëve, punonjësve të administratës, studentëve, bizneseve dhe çdo qytetari të interesuar një lexim i qartë dhe i saktë, përtej debateve politike i përparimit të Shqipërisë në të gjitha fushat pjesë të Kriteve të Kopenhagenit për anëtarësim në BE.

DËFTESA PËR KAPITULLIN 24 – DREJTËSI, SIGURI, LIRI

KAPITULLI 24	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024	NDRYSHIMI
<p>Lufta kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave</p>	<p>Përgatitja – Nota: 8</p> <p>Shqipëria ka njëfarë niveli përgatitjeje në zbatimin e Acquis së BE në luftën kundër krimit të organizuar. Kuadri strategjik përbëhet nga Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe plani i veprimit 2023-2025 i miratuar në shkurt 2023. Ndërkohë që Shqipëria ka një kuadër ligjor të plotë sa i përket konfiskimit të të ardhurave kriminale, Zyra për Rikuperimin e Aseteve nuk është ngritur ende, siç është parashikuar në ligjin e 2019 për administrimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara, dhe është e vonuar. Përgjigja e autoriteteve ligjzbatuese ndaj krimit të organizuar duhet të jetë më proaktive dhe sistematike. Është rritur numri i databazave që Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë qasje direkte. Sa i përket pastrimit të parave, si Regjistri për të dhënat bankare dhe ai për pronarët përfitues janë në funksion. Regjistri për pronarët përfitues është plotësuar pothuaj plotësisht, ku ka informacion mbi 99% të bizneseve dhe 94% të OJF-ve. Që nga korriku i 2022, sanksionet kanë filluar të zbatohen ndaj atyre që nuk kanë plotësuar detyrimet e raportimit (317 gjopa janë vendosur gjatë periudhës së raportimit). Hetimet financiare jo gjithmonë i ndjekin hetimet penale që nga fillimi, duke bërë që efektiviteti i tyre të jetë i kufizuar. Teknikat e hetimit financiar të ndjekura nga policia dhe prokurorët kanë ende nevojë për përmirësim. Nuk ka një qasje strategjike për identifikimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale. Shqipëria duhet të përshejtojë zbatimin e ligjit anti-mafia sa i përket konfiskimit, ngrirjes dhe ripërdorimit social të asetëve kriminale. Bashkëpunimi me Akademisë Shqiptare të Sigurisë dhe Agjencisë së BE për Trajnimin e Zbatimit të Ligjit është i përcaktuar mirë dhe bazohet në një marrëveshje pune. Rishikimi i kësaj marrëveshjeje dhe vendosja e një pike të re kontakti nuk janë realizuar ende.</p>	<p>Përgatitja – Nota: 8</p> <p>Shqipëria është midis njëfarë niveli dhe niveli mesatar të përgatitjes në fushën kundër krimit të organizuar. Shqipëria ka përafëruar pjesërisht legjislacionin e saj me atë të BE-së në këtë fushë. Po vijon zbatimi i Strategjisë kundër Krimit të Organizuar 2023-2025 dhe planit të saj të veprimit 2023-2025. Në mars 2023 u konsultua Projekt-ligji mbi ngritjen e Zyrës së Rikuperimit të Aseteve. Ai duhet të miratohet pa asnjë vonesë, dhe duhet të marrë në konsideratë përditësimet e ardhura nga Direktiva e BE e miratuar së fundi mbi zyrën e rikuperimit dhe konfiskimit. Është rritur numri i databazave që Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit kanë qasje direkte, duke përfshirë sistemet e të dhënave për doganat, sigurimet shoqërore dhe tatimet. Hetimet financiare jo gjithmonë i ndjekin hetimet penale që nga fillimi, duke bërë që efektiviteti i tyre të jetë i kufizuar. Nuk ka një qasje strategjike për identifikimin dhe konfiskimin e asetëve kriminale. Shqipëria duhet të realizojë konfiskimin e asetëve apo ngrirjen e tyre në rastet ku dyshohet që ato kanë ardhur si pasojë e krimit të organizuar, si një masë për të parandaluar aktivitetet kriminale; ndërkohë që edhe kur nuk ka ende një dënim final duhet të procedohet me konfiskimet. Teknikat e hetimit financiar të ndjekura nga policia dhe prokurorët kanë ende nevojë për përmirësim. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Agjencisë së BE për Trajnimin për Zbatimin e Ligjit (CEPO) vazhdon, por Shqipëria duhet të përfitojë më shumë nga ky bashkëpunim. Marrëveshja e rishikuar mes Akademisë së Sigurisë dhe CEPOL vazhdon të zbatohet. Shqipëria vazhdon të mbetet një pjesëmarrëse aktive në Platformën Europiane Shumëdimensionale kundër Kërcënimeve Penale (EMPACT) me 115 aksione të ndërmarrura në 2023 (nga 119 në 2022). Shqipëria udhëhoqi dy nga këto aksione, dhe ishte bashkëudhëheqëse në dy të tjera.</p>	<p>0</p>
<p>Lufta kundër krimit të organizuar dhe pastrimit të parave</p>	<p>Progresi – Nota: 8.5</p> <p>Njëfarë progresi është bërë për të realizuar rekomandimet e vitit të kaluar. Kuadri ligjor ka vazhduar të përafrohet më shumë me Acquis e BE, veçanërisht në fushën kundër pastrimit të parave. 60 hetuesit e BKH dhe prokurorët e posaçëm kanë marrë pjesë në trajnime asistuar nga aktorët ndërkombëtarë (BE dhe SHBA). Njëfarë progresi është bërë sa i përket kapjes dhe konfiskimit të asetëve të lidhura me krimin e organizuar. Kanë vazhduar përpjekjet për përmirësimin e historikut të të dhënave për luftën kundër krimit të organizuar. Ka progres sa i përket zbatimit të rekomandimeve të FATF, dhe FATF ka vlerësuar që është plotësuar në mënyrë të plotë plani i veprimit 2020-2023. Në tetor 2023 FATF vendosi të heqë Shqipërinë nga lista gri. Gjithsesi, FATF ka shprehur shqetësimin sa i përket planit të Shqipërisë për të miratuar një ligj për amnistinë fiskale dhe penale të subjekteve që bëjnë deklarinë vullnetar të pasurive, i cili duhet të jetë në përputhje me Acquis e BE dhe standardet ndërkombëtare. Historiku i të dhënave të personave për dënimet në kuadër të pastrimit të parave mbetet i paplotë. Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve i Policisë së Shtetit ka funksionuar në mënyrë të kënaqshme.</p>	<p>Progresi – Nota: 8.5</p> <p>Është bërë njëfarë progresi në luftën kundër krimit të organizuar. Kuadri ligjor ka vazhduar të përafrohet më shumë me Acquis e BE në këtë fushë. Shqipëria ka vazhduar të forcojë luftën e saj kundër pastrimit të parave. Në dhjetor 2023, u ngrit një grup pune ndër-institucional për të hartuar Strategjinë Kombëtare për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit 2024-2030, e cila u miratua në korrik 2024. Këshilli i Lartë i Prokurorisë realizoi emërimet e mbetura të SPAK, duke çuar numrin në 20 prokurorë specialë gjithsej. Zyra Speciale e Prokurorisë nisi punën me operacionet, pas finalizimit të rekrutimit të 12 hetuesve në 2023. Policia Gjyqësore pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH) nuk është ngritur ende pasi është në pritje të emërimit të Zëvendës Drejtorit të BKH. Numri i asetëve të kapura në 2023 u ul në mënyrë të ndjeshme. Shqipëria raportoi për 2023 që vlera e asetëve të kapura shkonte në rreth 21 milionë EUR (ndërkohë që në 2022 kishte raportuar 46 milionë EUR). Konfiskimi i asetëve pati një rritje, në një vlerë prej 11 milionë EUR në 2023, në krahasim me 5.8 milionë në 2022. Në 7 muajt e parë të 2024, Shqipëria ka raportuar vlerën në rreth 16 milionë euro të asetëve të kapura, dhe 4 milionë euro raportohet vlera e asetëve të konfiskuara. Projekti pilot i ri-përdorimit për arsye sociale të asetëve të konfiskuara ka qenë përgjithësisht jo-efektiv, pasi vet agjencia përgjegjëse nuk arrin të mbledhë asetet e përshtatshme për këtë qëllim, si dhe ndërmarrjet sociale nuk marrin ndonjë përfitim të dukshëm nga lehtësimi i taksave. Është rritur numri i përdoruesve të SIENA, dhe Njësia e Inteligjencës Financiare tashmë ka qasje në SIENA, duke plotësuar një nga rekomandimet speciale. Shqipëria ka marrë pjesë në mënyrë aktive në operacionet e përbashkëta të INTERPOL, me 26.7% më shumë operacione krahasuar me 2022.</p>	<p>0</p>

KAPITULLI 24	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024	NDRYSHIMI
Lufta kundër drogave	<p>Përgatitja – Nota: 5.5</p> <p>Shqipëria ende nuk ka një Strategji specifike kombëtare për Drogat. Disa aspekte për këtë çështje janë mbuluar nga Strategjia 2021–2025 kundër krimit të organizuar dhe planeve të saj të veprimit. Në gusht 2023, Shqipëria miratoi një ligj mbi kontrollin dhe procesimit e kanabisit dhe prodhimin e nën–produkteve të tij për arsye mjekësore dhe industriale. Duhet të vazhdojë konsultimi i BE sa i përket zbatimit të këtij ligji dhe të sigurojë që ka mekanizma për të parandaluar përdorimin e kanabisit për arsye të tjera. Mungesa e një vendi të sigurt depozitimi për drogat para shkatërrimit të tyre mbetet një çështje shqetësuese. Shqipëria duhet të ngre një bazë të përshtatshme për shkatërrimin e tyre dhe të mundësohet praktika që vetëm një mostër e vogël e masës së konfiskuar të ruhet si provë materiale në gjykatë.</p>	<p>Përgatitja – Nota: 6</p> <p>Legjislacioni kombëtar është pjesërisht i përputhur me acquis e BE në fushën e luftës kundër drogave. Shqipëria nuk ka ende një Strategji Kombëtare specifike për Drogat. Disa aspekte që lidhen me sigurinë janë mbuluar nga Strategjia kundër krimit të organizuar 2021–2025 dhe planeve të saj të veprimit. Nevoja për drogë dhe ulja e dëmeve nga drogat adresohen gjerësisht nga Strategjia Kombëtare e Shëndetit 2021–2030 dhe plani i dedikuar i veprimit. Policia e Shtetit realizon planet e veprimit mbi parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në kultivimin e bimëve narkotike. Plani më i fundit u miratua në janar 2024. Mbi kultivimin e kanabisit për arsye mjekësore dhe industriale, janë miratuar tre akte ligjore të kërkuara për zbatimin e ligjit, si dhe është emëruar Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare për Kontrollin e Kanabisit. Shqipëria duhet të sigurohet që të gjithë mekanizmat për parandalimin e përdorimit të kanabisit për arsye të tjera janë në funksion. Përmirësimi i rezultateve për identifikimin dhe shkatërrimin e bimëve narkotike, tregojnë një rritje të kapaciteteve operacionale të Policisë së Shtetit për të luftuar kultivimin e paligjshëm të kanabisit. Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor është mjaft i mirë. Shqipëria është e përfshirë në prioritetet e EMPACT.</p>	+0.5
Lufta kundër drogave	<p>Progresi – Nota: 6.5</p> <p>Ngritja e Observatorit Kombëtar për Drogën është ende në pritje. Edhe pse ka një koordinator për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm, ky sistem nuk është akoma në punë dhe duhet të vihet në zbatim sa më shpejt e pa vonesa. Me shtetet anëtare është ruajtur një nivel i mirë bashkëpunimi sa i përket luftës kundër trafikimit të narkotikëve. Trafikimi i drogave mbetet forma më e zakonshme e krimit të rëndë në Shqipëri, edhe pse numri i rasteve të identifikuar është ulur disi. Shqipëria mbetet i vetmi vend në rajon që lejon monitorimin nga një vend tjetër. Policia e Shtetit ka vazhduar monitorimin me drone. Sasia e kokainës së konfiskuar ka rënë nga 725 kg në 2021 në 578 në 2022, por sërish mbetet një sasi e konsiderueshme.</p>	<p>Progresi – Nota: 7</p> <p>Observatori Kombëtar për Drogën nuk është ngritur ende dhe sistemi i paralajmërimit të hershëm për substancat e reja psikoaktive nuk është akoma në punë. Këto janë parakushte thelbësore për një politikë efektive të drogave. Ligji mbi barnat narkotike dhe lëndët psikotrope u ndryshua në dhjetor 2023. Vazhdon monitorimi nga ajri me mbështetjen e shtetit italian, për identifikimin e plantacioneve të kanabisit. Ka pasur një trend zbritës sa i përket identifikimit të trafikimit të drogës, që ka çuar në një rënie të sasisë së drogës së konfiskuar.</p>	+0.5

Migracioni
dhe Azili

Përgatitja – Nota: 8.5

Kuadri ligjor mbi **migracionin është i përpunur pjesërisht** me Acquis e BE. Ligji i 2021 **për azilin është i përpunur gjerësisht** me Acquis e BE. Pavarësisht se ligji i ofron azilkërkuësve të drejtën për të aksesuar shërbimet publike, në të njëjtën mënyrë si shtetasit shqiptarë, **moskoordinimi i këtij ligji** me aktet e tjera ligjore **nuk lejon të ketë një qasje efektive**. Plani i miratuar dhe i përditësuar i kontigjencës për një mundësi të një rritjeje substanciale të migrantëve dhe azilkërkuësve **duhet të përfshijë dhe buxhetin e duhur**. Edhe zbatimi i Planit kombëtar kundër trafikimit të qenieve njerëzore 2021-2023 **duhet të mbështetet nga burime të përshtatshme financiare** dhe nga një koordinim më i mirë. Kuadri ligjor për viktimat, duke përfshirë dhe ndryshimet në Kodin e Procedurës penale, **nuk po zbatohet ende**. Që nga qershori i 2023, **stafi** i Departamentit të Policisë për Kufirin dhe Migracionin **është rritur me 19%** krahasuar me 2021. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Frontex sa i përket operacioneve të kthimit **është shumë i mirë**. Sa i përket azilit, Shqipëria **ka të gjitha institucionet e nevojshme** për të menaxhuar kërkesat e azilit. **Apelimi administrativ mund të bëhet pranë Komisionit Kombëtar për Refugjatët dhe Azilin**. Duket qenë që vetëm **1% e migrantëve** që kanë ardhur në Shqipëri në 2022, u janë drejtuar kërkesës për azil tregon që **duhet të ketë një përmirësim** të qasjes për procedurat e azilit. **Mungesa** e përkthyesve të përgatitur në qendrat e përkohshme të pritjes duhet që të adresohet. Në trafikimin e qenieve njerëzore, **identifikimi** i viktimave potenciale **mbetet i pamjaftueshëm**.

Përgatitja – Nota: 9

Kuadri ligjor mbi **migracionin është i përpunur pjesërisht** me Acquis e BE dhe **ka nevojë që të përditësohet** me zhvillimet më të fundit ligjore të BE. Që nga hyrja në fuqi e Ligjit për të huajt në vitin 2021, 30 akte për zbatimin e legjislacionit **janë miratuar** deri më tani: 4 prej tyre në 2024. Ndërkohë rishikimi i Ligjit për të huajt **është në proces**. Kuadri ligjor për azilin **është i kompletuar** dhe **është i përpunur gjerësisht** me Acquis e BE. Por menaxhimi i azilit në praktikë **ka nevojë që të përmirësohet**. Plani i përditësuar i kontigjencës për mundësinë për një rritje substanciale të migrantëve dhe azilkërkuësve **duhet të miratohet**, së bashku me buxhetin përkatës. Kuadri ligjor kundër trafikimit të qenieve njerëzore **është pjesërisht i përpunur** me Acquis e BE. Plani kombëtar i veprimit për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore (2024-2025) **u miratua** në korrik 2024. Sa i përket azilit, Shqipëria **ka të gjitha institucionet e nevojshme** për të menaxhuar kërkesat e azilit. **Janë të nevojshme** më shumë investime sa i përket kapaciteteve administrative dhe si për mirëfunksionimin e sistemit të azilit. Riintegrimi i qytetarëve të kthyer, sidomos për ata që u përkasin grupeve vulnerabël **duhet që të përmirësohet**. Bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Frontex sa i përket operacioneve të kthimit **është shumë i mirë**. Menaxhimi i çështjeve për fëmijët e pashoqëruar **nuk realizohet** nëpërmjet një procesi të integruar. Drejtoria e Azilit, e të Huajve dhe Shtetësisë **ka nevojë për më shumë kapacitete** teknike për të vlerësuar kërkesat për azil në mënyrë që të merren vendime të bazuara në informacion të plotë. Autoritetet shqiptare **duhet të forcojnë** kapacitetet e tyre për të identifikuar, hetuar dhe gjykuar trafikuesit e qenieve njerëzore, si dhe për të zbatuar plotësisht Mekanizmin Kombëtar të Referimit për viktimat e trafikimit.

+0.5

Migracioni
dhe Azili

Progresi – Nota: 9

Zbatimi i strategjisë kombëtare të migracionit dhe planit të veprimit 2019-2022 **përfundoi në dhjetor 2022**. Nga 129 masa, **72 janë raportuar si të zbatuara plotësisht**, 36 të zbatuara pjesërisht dhe **21 të pazbatuara**. Në mars 2023 **u ngrit** grupi i punës ndër-institucional **për hartimin** e strategjisë së re të migracionit 2024-2030. 15 aktet nënligjore në kuadër të Ligjit për Azilin **janë miratuar**. Një udhëzim i rishikuar për procesin pre-screening **është miratuar** që në 2022, por zbatimi i tij në praktikë **duhet të përmirësohet**. Shqipëria **mbetet** një vend origjine, tranziti por edhe destinacioni sa i përket trafikimit të qenieve njerëzore. Numri i personave me shtetësi shqiptarëve të ndaluar në BE për trafikim **mbetet i lartë**, si një nga **10 vendet e para** të origjinës jo-BE. Draft-marrëveshje ripranimi janë dërguar nga Shqipëria drejtuar vendeve të ndryshme të origjinës, por **deri tani pa rezultat**. Marrëveshja e ripranimit me BE **po funksionon mirë**, ku Shqipëria **respekton në mënyrë të shpejtë** kërkesat nga Shtetet Anëtare. Kapacitetet pritëse **janë rritur** që në 2021 me rinovimin e Qendrës Kombëtare Pritëse në Babrru. Në korrik 2023 një qendër e përkohshme pritëse **u çel** në Qafë-Botë. Që nga marsi i 2022, refugjatët nga Ukraina **kanë të drejtë** të qëndrojnë në Shqipëri deri në një vit pa pasur nevojë për një leje qëndrimi. Shqipëria **ka bashkëpunuar** me BE, Shtetet Anëtare dhe vendet fqinje për zbatimin e **Planit të Veprimit të BE** prezantuar në dhjetor 2022, **duke kontribuar në menaxhimin** e flukseve mikse të migracionit drejt BE.

Progresi – Nota: 9

Në maj 2024 **u miratua** Strategjia Kombëtare e Migracionit (2024-2030), shoqëruar nga plani i veprimit (2024-2026). Strategjia **përfshin prioritetet dhe objektivat e vendosura** nga Plani i Veprimit të BE për Ballkanin Perëndimor. Shqipëria, në mars 2023 **bëri kërkesë** për të marrë statusin e vëzhguesit pranë Rrjetit Europian të Migracionit. Zbatimi i planit të veprimit dhe mbikëqyrja e kufirit, së bashku me kontrollin e përbashkët nëpërmjet Skuadrave të Frontex në kufirin grek **kanë bërë të mundur** që numri i imigrantëve të parregullt **të ulet në mënyrë të ndjeshme**. Shqipëria **mbetet** më së shumti një vend tranziti. Pavarësisht se **ka një rënie të numrit** të imigrantëve të parregullt që hyjnë në Shqipëri, numri i kërkesave për azil **është dyfishuar** në vitin 2023 në krahasim me 2022. Vetëm 5.7% e migrantëve që janë ndaluar në Shqipëri, **kanë bërë kërkesë** për azil. Shqipëria **ka bërë përpjekje** që të negociojë marrëveshjet e ripranimit me disa vende të origjinës, por **deri tani pa rezultat**. Numri i shtetasve të vendeve të treta që kthehen nga Shqipëria vullnetarisht drejt vendit të tyre të origjinës **mbetet shumë i ulët**. Marrëveshja e ripranimit me BE **po funksionon mirë**. Ka një **bashkëpunim shumë të mirë** mes Shqipërisë dhe Frontex mbi operacionet e kthimit. **Mbetet sfiduese** për Policinë e Kufirit dhe Migracionit për të identifikuar dhe për të referuar ata persona që mund të kenë nevojë për mbrojtje të përkohshme. Shqipëria momentalisht **ka kapacitete pritëse të mjaftueshme** me rreth 600 shtretër, përfshirë 220 shtretër që naodhen në qendrën pritëse të azilit në Babrru. Në këto qendra **nuk ekzistojnë hapësira të ndara** dhe të dedikuara për të miturit e pashoqëruar, përveçse në qendrën pritëse të përkohshme në Ersekë. **Vetëm një person** ka marrë statusin 'refugjat' në Shqipëri, që nga 2018.

0

Politika e
Vizave dhe
Shengeni

Përgatitja – Nota: 8.5

Politika e vizave dhe menaxhimi i kufijve të jashtëm nuk është ende i përafuar plotësisht me Acquis e BE. Megjithatë, strategjia 2021-2027 dhe plani i veprimit 2021-2023 mbi menaxhimin e integruar të kufirit **janë të përafuara gjerësisht**. Praktika e lehtësimit të përkohshëm të vizave dhe ligji mbi Kontrollin e kufirit që parashikon Informacionin e Avancuar të Udhëtarëve dhe Regjistrimin e Emrit të Pasagjerit **nuk janë në përputhje** me Acquis e BE. **Vëmendje më e madhe** duhet ti kushtohet riintegritimit të suksesshëm të të kthyerve, sidomos atyre që janë më vulnerabël. Këndet e migracionit të ngritura në bashkitë për të rikthyerit **duhet të formalizohen dhe të fuqizohen**. Marrëveshja BE-Shqipëri e firmosur në shtator 2023, lejon **Policinë Europiane të Kufirit dhe Bregdetit të përfshihet** dhe në kufijtë jo të BE-së. Sistemi i integruar i radarit për mbikëqyrjen e kufirit blu (detit) **është funksional**. Një sektor i hetimit **është ngritur** në policinë e kufirit dhe migracionit me qëllim parandalim, identifikimit dhe luftën kundër aktiviteteve të paligjshme të kalimit të kufirit. Ky është **një zhvillim shumë pozitiv**.

Përgatitja – Nota: 8.5

Politikat e vizave dhe menaxhimi i kufijve të jashtëm **nuk është ende i përafuar plotësisht** me Acquis e BE, **sidomos nuk ka përputhje** me listën e BE për vendet e treta, qytetarët e të cilëve duhet të jenë të pajisur me vizë. **Vazhdon zbatimi** i strategjisë kombëtare mbi menaxhimin e integruar të kufirit 2021-2027. Ligji mbi Kontrollin e kufirit që parashikon Informacionin e Avancuar të Udhëtarëve dhe Regjistrimin e Emrit të Pasagjerit **nuk është në përputhje me Acquis e BE**. Sistemi i menaxhimit të informacionit (TIMS) **vijon ende të ketë probleme** në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave, dhe këto probleme **duhet të adresohen sa më shpejt**. Me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së re me Frontex në qershor 2024 **është bërë i mundur** dislokimi operacional përgjatë gjithë kufijve të vendit.

0

Politika e
Vizave dhe
Shengeni

Progresi – Nota: 7

Raporti i 6 i Komisionit nën mekanizmin e pezullimit të liberalizimit të vizave doli në përfundim që Shqipëria **ka marrë masa për të adresuar rekomandimet** e një viti më parë. Një marrëveshje reciproke e liberalizimit të vizave **me Kinën u firmos** në shkurt 2023, që është një vendim i njëanshëm i Shqipërisë. Duke ndjekur kërkesat e BE, Shqipëria **vendosi të mos zgjasë** aksesin sezonal pa viza të shtetasve nga Egjipti, India dhe Rusia, që vlerësohet **si një progres i konsiderueshëm**. Pati **një rritje me 33%** të numrit të shtetasve shqiptarë që u refuzohet dalja nga territori shqiptar. Kjo mund ti atribuohet **fuqizimit të kontrolleve** të kalimit të kufirit. **Zbatimi i suksesshëm** i operacioneve të përbashkëta tokësore dhe detare **me Frontex vazhdoi** dhe në 2022. Bashkëpunimi me fqinjët **vazhdon të jetë i mirë**. Sipas të dhënave të Eurostat, numri i aplikimeve për azil nga qytetarët shqiptarë **është rritur me 16%** në 2022 në krahasim me 2021, por përsëri **mbetet shumë poshtë vlerave para pandemisë**. Prodhimi dhe shpërndarja e dokumenteve biometrike **janë transferuar** si përgjegjësi nga një kompani private **te një agjenci shtetërore e krijuar që nga gushti 2023**. Vendi **vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive** në Rrjetin e Analizës së Riskut të Ballkanit Perëndimor.

Progresi – Nota: 7

Raporti i 6 i Komisionit nën mekanizmin e liberalizimit të pezullimit të vizave doli në përfundim që Shqipëria **ka marrë masa për të adresuar** pjesën më të madhe të rekomandimeve. Shqipëria **ende vazhdon** të ketë një regjim pa viza me 13 shtete, 7 prej tyre kanë liberalizim vizash të përhershëm dhe 6 e kanë të përkohshëm (kjo praktikë **është në mospërputhje** me Acquis e BE). Ndërkohë këto shtete janë pjesë e listës së BE për të cilat kërkohet viza. Pati **një rritje me 8.8%** të numrit të shtetasve shqiptarë që u refuzohet dalja nga territori shqiptar. Kjo mund ti atribuohet **fuqizimit të kontrolleve** të kalimit të kufirit. **Zbatimi i suksesshëm** i operacioneve të përbashkëta tokësore dhe detare me Frontex **vazhdoi** dhe në 2023. Shqipëria **realizoi** 1 127 patrulla të përbashkëta ose **15% më shumë** se në 2022, me vende si Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Italia, bazuar në protokollet përkatëse që ka me këto vende. Sipas të dhënave të Eurostat, numri i aplikimeve për azil nga qytetarët shqiptarë **ka rënë me 30%** në 2023 në krahasim me 2022.

0

Krimi kibernetik dhe anti-terrorizmi	<p>Përgatitja – Nota: 8</p> <p>Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit dhe është disi e avancuar në përafrimin me Acquis e BE. Shqipëria është palë e të gjitha konventave kundër terrorizmit të Këshillit të Europës. Në korrik 2022, Shqipëria ishte viktimë e një sulmi kibernetik në një shkallë të gjerë, që solli ndërprerje të përkohshme të shumicës së shërbimeve publike online. Qendra e Koordinimit të CVE dhe Drejtoria kundër terrorizmit të Policisë së Shtetit kanë udhëhequr punën ndërinstitucionale për riintegrimin dhe rehabilitimin në mënyrë efektive dhe profesionale. Kapacitetet për hetimin dhe ndjekjen penale të krimeve kundër fëmijëve nëpërmjet internetit duhet të forcohen. Njësitë e krimeve kibernetike të Policisë së Shtetit ka një laborator të mjekësisë ligjore, por duhet të rrisë kapacitetet. Shqipëria duhet të vazhdojë të përqendrohet në riintegrimin dhe rehabilitimin e të kthyerve nga Siria.</p>	<p>Përgatitja – Nota: 7.5</p> <p>Kuadri ligjor shqiptar në fushën kundër terrorizmit është pjesërisht në përputhje me Acquis e BE. Shqipëria duhet gjithashtu të përafrojë legjislacionin e saj mbi lëndët shpërthyes me atë të BE. Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Kjo politikë udhëhiqet nga strategjia për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit (2023-2025) dhe nga dy planet e veprimit. Qeveria nuk ka alokuar mjaftueshëm fonde për t'i zbatuar ato. Sidoqoftë, nevojitet përmirësimi i kapaciteteve për të monitoruar dhe luftuar financimin e terrorizmit, përfshirë edhe përmes organizatave jo fitimprurëse. Niveli i përgatitjes për mbrojtjen e infrastrukturës kritike mbetet i ulët. Lufta kundër terrorizmit në përgjithësi është në nivel të kënaqshëm. Shqipëria duhet të zhvillojë kapacitetet e saj për të hetuar krimin kibernetik për të përmbushur prioritetet e BE-së 2022-2025 për EMPACT. Shqipëria ka një koordinator kombëtar kundër ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, ndryshimet e shpeshta të kryesisë dhe lëvizja e shpeshtë e stafit dëmtojnë efektivitetin e punës së tij. Rehabilitimi dhe rinteprimi i anëtarëve të familjeve të luftëtarëve terroristë të atdhesuar nga Siria po trajtohet në mënyrë efektive. Autoritetet duhet të ulin varësinë e tyre nga aktivitetet e financuara nga donatorët, dhe duhet të alokojnë një buxhet të përshtatshëm për të siguruar qëndrueshmëri.</p>	-0.5
--------------------------------------	---	---	------

Krimi kibernetik dhe anti-terrorizmi	<p>Progresi – Nota: 7.5</p> <p>Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Sigurisë Kibernetike 2020-2025, akte të reja ligjore dhe nënligjore mbeten për t'u miratuar. Ndryshimet ligjore për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijës në internet mbeten për t'u miratuar. Shqipëria është pjesë e Konventës së Budapestit për krimin kibernetik dhe në shkurt 2023 nënshkroi Protokollin e Dytë Shtesë për Konventën. Në mars 2022, qeveria miratoi një strategji ndërsëktorale për 2022-2025 dhe dy plane zbatimi për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe për të luftuar terrorizmin. Fondet e nevojshme për të zbatuar planet e zbatimit duhet të buxhetohen. Ka bërë progres të mirë në zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe me BE-në për operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit. Një marrëveshje dypalëshe e rishikuar me BE u nënshkrua në dhjetor 2022 dhe po zbatohet. Puna ka avancuar në krijimin e një mekanizmi për vlerësime të përbashkëta kombëtare të kërcënimeve, si për Mbrojtjen e Infrastrukturës Kritike. Shqipëria duhet të përdorë në mënyrë më proaktive aftësitë e Qendrës së Europol kundër Terrorizmit. Ajo mori pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e nismës kundër terrorizmit të Ballkanit Perëndimor. Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacionit të ndjeshëm me partnerët ndërkombëtarë mbetet i kënaqshëm.</p>	<p>Progresi – Nota: 7</p> <p>Bazuar në Strategjinë Kombëtare për Sigurisë Kibernetike 2020-2025, akte të reja ligjore dhe nënligjore mbeten për t'u miratuar. Ndryshimet ligjore për të kriminalizuar të gjitha format e abuzimit seksual të fëmijës në internet mbeten për t'u miratuar. Shqipëria ka bërë progres për zbatimin e Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe për të luftuar terrorizmin. Shqipëria vazhdon të zbatojë Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor. Nuk ka një progres të prekshëm sa i përket ngritjes së një grupi ndërinstitucional për krijimin e një mekanizmi për vlerësime të përbashkëta kombëtare të kërcënimeve. Radikalizimi dhe përmbajtjet terroriste online mbeten sfida madhore. Gjithashtu vitet e fundit, ka një rritje të përpjekjeve nga entitetet e huaja për të ndikuar komunitetet fetare në Shqipëri. Në nivel rajonal, Shqipëria ka themeluar në 2023 një mekanizëm referimi përgjegjës për të identifikuar dhe referuar raste të radikalizimit në qendrën e koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm (CVE). Policia e Shtetit ka referuar 8 raste të shkeljeve penale me qëllime terroriste në 2023, dhe 13 raste në 2024. Qeveria ka vazhduar përpjekjet e saj për të riatdhesuar fëmijët dhe gratë e mbetura në kampet e Sirisë.</p>	-0.5
--------------------------------------	---	---	------

KAPITULLI 24	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2023	RAPORTI I KOMISIONIT EUROPIAN 2024	NDRYSHIMI
Bashkëpunimi gjyqësor	<p>Përgatitja – Nota: 8.5</p> <p>Shqipëria duhet të përfundojë procedurat e brendshme për aderimin në Konventën e Hagës 2005 mbi marrëveshjet gjyqësore dhe Protokollin 2007 mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes. Ngritja e ekipeve të përbashkëta hetimore është lehtësuar nga mbështetja financiare e BE-së. Ajo duhet të përmirësojë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar. Prokurori ndërlidhës shqiptar u emërua në Eurojust në janar 2021 dhe ndihmoi në lehtësimin e bashkëpunimit gjyqësor. Vazhdimësia e këtij angazhimi u sigurua në qershor të vitit 2023 me zgjatjen e mandatit.</p>	<p>Përgatitja – Nota: 9</p> <p>Në shkurt 2024, Shqipëria firmosi Konventën e Hagës 2005 mbi marrëveshjet gjyqësore dhe Protokollin 2007 mbi Ligjin e Zbatueshëm për Detyrimet e Mirëmbajtjes, dhe i ratifikoi ato në qershor 2024. Bashkëpunimi gjyqësor mbi çështjet civile dhe penale është gjerësisht i kënaqshëm. Bashkëpunimi me Zyrën Europiane të Prokurorit Publik (EPPO) është tërësisht funksional.</p>	+0.5
Bashkëpunimi gjyqësor	<p>Progresi – Nota: 10</p> <p>Shqipëria merr pjesë në mënyrë aktive me dy përfaqësues në projektin rajonal WB CRIM JUST të Eurojust. Kjo ka sjellë ndërveprim më të madh midis prokurorëve në Ballkanin Perëndimor me qëllim koordinimin e hetimeve të tyre. Me mbështetjen e BE-së, në 2022 Shqipëria dyfishoi pjesëmarrjen e saj në grupet e përbashkëta hetimore (JITS). Në 2022, Zyra Ndërlidhëse Shqiptare me Eurojust regjistroi 38 raste me kërkesë të autoriteteve shqiptare, që përfaqëson një rritje prej 81% krahasuar me vitin 2021. Ndër vendet joanëtare të BE-së, Shqipëria kishte numrin e katërt më të madh të rasteve të Eurojust-it në vitin 2022. Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet Zyrës Europiane të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë së Përgjithshme dhe SPAK u nënshkruan përkatësisht (korrik 2022, qershor 2023) për të lehtësuar bashkëpunimin në çështjet penale dhe shkëmbimin e informacionit.</p>	<p>Progresi – Nota: 10</p> <p>Bashkëpunimi gjyqësor është rritur gjatë periudhës 2021-2023 si për çështjet civile ashtu dhe ato penale. Kjo rritje ka ardhur si për kërkesat e dërguara dhe ato të marra nga shteti shqiptar. Shqipëria vazhdon të marrë pjesë në mënyrë aktive me dy përfaqësues në projektin rajonal WB CRIM JUST të Eurojust. Kjo ka sjellë ndërveprim më të madh midis prokurorëve në Ballkanin Perëndimor me qëllim koordinimin e hetimeve të tyre. Shqipëria ka rritur pjesëmarrjen e saj në grupet e përbashkëta hetimore në 22 (19 në 2023). Pjesa më e madhe e këtyre grupe vijojnë punën e tyre në fushën e luftës kundër narkotikëve.</p>	MAX